



Observatori për të drejtat e Fëmijëve
Qarku Gjirokastër

Qarku i Gjirokastrës ka një sipërfaqe prej 2,884 km² me popullsi të regjistruar prej 156,751 banorësh[1] të vendosur në 42,269 familje[2] dhe me një dendësi popullsie prej 54.35 banorë për km². Krahasuar me vitin 2009, popullsia është rritur 0.4% (600 banorë) duke sjelle ndryshimin e dendësisë me 0.2 banorë për km². Gjirokastra ndodhet në qendër të Shqipërisë Jug - Lindore dhe përshkohet nga dy lugina të rëndësishme të Shqipërisë Jugore, nga Lugina e Vjosës së Sipërme dhe



1 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme (2011)

2 Shërbimi Social Shtetëror – Tiranë, Qershor 2011. Të dhënat për komunat Qendër Libohovë, Odrie, Lunxhëri, Antigone dhe Zagorie, janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme (2011)

nga lugina e Lumit Drino. Në këto lugina është përqendruar edhe pjesa më e madhe e popullsisë së qarkut Gjirokastër si dhe në të njëjtën kohë ato përbëjnë edhe pjesët kryesore të zhvillimit ekonomik dhe industrial të rajonit.

Qarku i Gjirokastrës ka si qendër administrative qytetin e Gjirokastrës, një qytet mesjetar që daton si vendbanim i konsoliduar që prej shekullit të XIII; me ndërtesa tipike të arkitekturës orientale të përzier me elementët vendas. Për veçantinë e arkitekturës dhe vlerave të saj të rralla mesjetare, Gjirokastra është përfshirë në Trashëgiminë Botërore të mbrojtur nga UNESCO që prej vitit 2005, si dhe është përfshirë në një numër të konsiderueshëm reklamash turistike ndërkombëtare.

Qarku i Gjirokastrës përfshin rrethet:

1. *Gjirokastër* me lartësi mesatare 400 m mbi nivelin e detit dhe të përbërë nga dy bashki dhe 11 komuna (96 fshatra) me një popullsi prej 84,430[1].

2. *Tepelenë,* e përbërë nga dy bashki dhe 8 komuna (77 fshatra) me një popullsi prej 38708 banorë[2];

3. *Përmet,* e përbërë nga dy bashki dhe 7 komuna (98 fshatra) me një popullsi prej 33,613 banorë[3].

1 Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Bredhshme, Mars 2011
2 Ibid;
3 Ibid;





Përshkrim mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Qark:

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Tiranë, totali i popullsisë të grupmoshës 0-15 vjeç për vitin 2010 është 31,234 banore ose 20% e popullsisë totale të Qarkut Gjirokastër;

Raporti i fëmijëve të moshës 0-15 vjeç sipas zonës së banimit (urban/rural) për çdo rreth është: Gjirokastër 7793 (51.45%) fëmijë banojnë në zona urbane kundrejt 7,353 (48.55%) fëmijë banojnë në zona rurale;Tepelenë 3,131 (34.61%) fëmijë banojnë në zona urbane kundrejt 5,915 (65.39%) fëmijë banojnë në zona rurale; Përmeti 3,078 (43.71%) fëmijë banojnë në zona urbane kundrejt 3964 (56.29%) fëmijë banojnë në zona rurale.

Referuar Hartave të Varfërisë dhe Pabarazisë, Qarku i Gjirokastrës është ndër zonat që kanë nivelin më të ulët të varfërisë dhe pabarazisë në Shqipëri për vitin 2009 e 2010. Kjo vihet re edhe nëse i referohemi treguesit të numrit të familjeve që përfitojnë nga skemat e ndihmës ekonomike. Sipas të dhënave të marra nga Zyra Rajonale e Shërbimeve Sociale Gjirokastër, gjatë vitit 2010 numri total i familjeve me fëmijë të grupmoshës 0-15 vjeç që përfitojnë nga skemat e ndihmës ekonomike është 1378 (vetëm 2.99% të totalit të familjeve në këtë qark). Numri total prej 1678 fëmijësh të grupmoshës 6-15 vjeç përbën 1.07% të popullsisë se përgjithshme të qarkut.





Analiza në bazë rrethi tregon:

- Në rrethin e Gjirokastrës 158 familje me një numër total prej 177 fëmijësh të grupmoshës 6-15 vjeç, prej të cilëve 150 jetojnë në zona urbane dhe 27 në zona rurale;
- Në rrethin e Tepelenës janë 674 familje me një numër total prej 877 fëmijësh të grupmoshës 6-15 vjeç prej të cilëve 371 jetojnë në zona urbane dhe 506 fëmijë jetojnë në zonat rurale,
- Në rrethin e Përmetit janë 626 familje me një numër total prej 624 fëmijësh prej të cilëve 167 jetojnë në zonat urbane dhe 457 jetojnë në zonat rurale.



Të gjithë këta fëmijë janë të regjistruar në sistemin e detyruar arsimor 9-vjeçar. Nuk ka të dhëna për frekuentimin e sistemin parashkollor të grupmoshës 0-6 vjeç nga Zyra Rajonale e Shërbimeve Sociale Gjirokastër. Megjithatë cilësia e mësimdhënies dhe përmirësimi i ndjeshëm i infrastrukturës së kopshteve ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e përqindjes së fëmijëve të regjistruar në kopshte .Në vitin mësimor 2008-2009 në rrethin e Gjirokastrës u hapën 4-klasa përgatitore me fëmijë 5-6 vjeçarë, të cilët nuk kishin frekuentuar kopshtin, kurse në vitin mësimor 2010-2011 në qarkun e Gjirokastrës funksionojnë 10 kopshte të tilla ku frekuentojnë 220 fëmijë. Në qarkun e Gjirokastrës rreth 79 % e fëmijëve që janë regjistruar në klasë të parë kanë frekuentuar kopshtin 1-vit.

Në nivel qarku 13% e fëmijëve janë të regjistruar në klasë të parë mbi moshën e detyrimit zyrtar. Edhe pse kjo është një përqindje e vogël, mosnjohja nga ana e prindërve e ligjit për detyrimin shkollor dhe mos-frekuentimi i kopshtit nga kjo pjesë e fëmijëve për arsye shëndetësore dhe largësia e godinave shkollore ka sjellë rezultatin që këta nxënës të regjistrohen mbi moshën e përcaktuar në detyrimin zyrtar.

Sipas dokumentit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës me titull "Standardet e normave dhe kritereve të projektimit", *numri i nxënësve për shkolla në zona me 2000 deri me 10.000 banore duhet të luhatet ndërmjet 250 e 500 nxënësve*, por për shkak të lëvizjeve të lira të popullsisë, emigrimit dhe ndryshimeve ekonomiko-shoqërore vihet re tendenca për përqendrimin e popullsisë në zonat e mëdha urbane.

Aktualisht në qarkun e Gjirokastrës kemi një panoramë të tillë të shpërndarjes së shkollave dhe numrit të nxënësve në arsimin 9-vjeçar dhe atë të mesëm.

Në vitin mësimor 2010-2011 frekuentojnë arsimin 9-vjeçar 9090 nxënës nga të cilët :

- në qytet 5261 nxënës në 15 shkolla
- në fshat 3829 nxënës në 52 shkolla

Në arsimin e mesëm në vitin mësimor 2010-2011 frekuentojnë 3258 nxënës nga të cilët:

- në qytet 2490 në 10 shkolla
- në fshat 768 në 11 shkolla

Nga të dhënat zyrtare të DAR Gjirokastër dhe në zbatim të aksionit kombëtar, mbështetur nga Plani i veprimit për reduktimin në zero të braktisjes shkollore, rezulton se braktisja shkollore krahasuar edhe me zona të tjera të Shqipërisë nuk përben problem shqetësues.

Observatori për të drejtat e fëmijës është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur ne qarkun e Gjirokastrës në vitin 2010, e cila në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë bën mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkeljen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të

Observatori për të drejtat e Fëmijëve, Qarku Gjirokastër gjendet në
"Qafa e Pazarit", përballë Gjykatës,
Gjirokastër, Shqipëri
e-mail: observatori_gji@yahoo.com
URL: www.observator.org.al





Politika Rajonale në ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve

Në qarkun e Gjirokastrës është hartuar Strategjia Rajonale për të drejtat e fëmijëve.

Në dobi të realizimit dhe përmbushjes të të drejtave të fëmijëve, në Qarkun Gjirokastër, veç zyrës së Observatorit, është ngritur dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Fëmijëve" në Qark.









Shënim: Të dhënat "Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa ujë të përmirësuar të pijshëm, energji elektrike, që jetojnë në banesa të papërshtatshme dhe përqindja e fëmijëve me 1 ose 2 prindër të pa punë",- janë marrë nga studimi i thelluar me autorë A. Ceni dhe V. Kolpeja.